

Biografi e shkurtër – Dorina Lluka-Davies

Dorina Lluka-Davies është një profesioniste me mbi 25 vite përvojë në zhvillimin e rinisë, fuqizimin e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale në Kosovë dhe rajon. Ajo aktualisht është përfaqësuese ligjore e YMCA në Kosovë, ndërsa njëkohësisht mban edhe rolin e Koordinatorës Rajonale për Zhvillim në Ballkanin Perëndimor, i mbështetur nga YMCA e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjatë karrierës së saj, Dorina ka dizajnuar dhe implementuar programe të shumta në fushën e edukimit joformal, lidërshipt, mirëqenies së të rinjve dhe pjesëmarrjes qytetare. Ajo është themeluese e Programit të Lidërshipt të YMCA, i cili ka kontribuar në zhvillimin e aftësive të mijëra të rinjve dhe në rritjen e punësueshmërisë së tyre.

Në nivel rajonal, ajo ka kontribuar në forcimin e organizatave të shoqërisë civile përmes zhvillimit të standardeve të qeverisjes së mirë, rritjes së kapaciteteve dhe krijimit të partneriteteve ndërsektoriale. Përvoja e saj përfshin udhëheqjen e proceseve komplekse organizative, zhvillimin e programeve strategjike dhe mbështetjen e organizatave drejt modeleve më të qëndrueshme dhe të vetëqëndrueshme.

Dorina është e njohur për ekspertizën e saj në konsulencë për zhvillimin institucional të organizatave të shoqërisë civile, me fokus në qeverisjen e mirë, ndërtimin e programeve të qëndrueshme dhe krijimin e mekanizmave për vetëqëndrueshmëri financiare. Ajo ka mbështetur YMCA në Kosovë për ndërtimin dhe blerjen e 5 objekteve/ndertesave fizike duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë me investime kapitale. Po ashtu ka ndihmuar organizata të ndryshme në hartimin e strategjive afatgjatë dhe në forcimin e ndikimit të tyre në komunitet.

Ajo mban një diplomë Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë dhe një diplomë Master në Psikologji Sociale dhe Organizative.

Me një përkushtim të vazhdueshëm ndaj zhvillimit demokratik dhe fuqizimit të sektorit civil, Dorina synon të kontribuojë në Bordin e Platformës CiviKos përmes përvojës së saj të gjerë, qasjes strategjike dhe fokusit në qëndrueshmëri, transparencë dhe ndikim afatgjatë të organizatave anëtare.